

MENDIM PARALEL

Unë, anëtarja e trupit gjykues nr. 2, Valbona Sanxhaktari, parashtoj mendimin tim paralel ndaj arsyetimit të vendimit nr.154 datë 10.6.2019, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit znj. Enkeledi Hajro, me detyrë gjyqtare/kryetare, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Parashtrimi i arsyetimit i mendimit paralel lidhet me qëndrimin ndryshe në raport me vlerësimin e disa shkaqeve të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, por që, pavarësisht arsyetimit ndryshe, nuk ndikon në vendimin e trupit gjykues për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Enkeledi Hajro, e cila, edhe në vlerësimin tim, nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

1. Lidhur me vlerën e pasurisë: apartament banimi në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sipërfaqe funksionale 85 m², e ndodhur në rrugën “**”, ndërtesa nr. ***, hyrja nr. ***, apartamenti nr. ***, Tiranë, sipas kontratës së shitblerjes (82.000 euro) dhe sipas kredive në “Alpha Bank” dhe “BKT” (70.000 euro).**

Në deklaratën “Vetting”, subjekti deklaron kontratë shitblerje apartamenti në vlerën 82.000 euro dhe si burim vetëm vlerën 70.000 euro nga kontrata e kredisë me “Alpha Bank”.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se këtë pasuri e ka blerë me kredi të marrë nga “Alpha Bank” në vlerën prej 70.000 eurosh, pasi banka mbulonte vetëm 70% të vlerës së blerjes së apartamentit dhe kontratës së kredisë për blerje apartamenti në datën 31.7.2007. Kjo kredi është blerë në shtator të vitit 2012 nga “BKT”, në vlerën prej 8.600.000 lekësh. Kredia në fjalë përbëhet nga dy kredi: (1) kredi shtetërore, me vlerë 5.000.000 lekë, me interes fiks 4%; dhe (2) kredi tregtare në vlerën 3.600.000 lekë me interes të ndryshueshëm, vlera nominale e deklaruar e apartamentit 82.000 euro.

Jam kundër vendimit të shumicës, të cilët kanë konsideruar dhe llogaritur vlerën e apartamentit 82.000 euro, dhe për pasojë, subjekti ka rezultuar në pamundësi financiare për të paguar shumën prej 7.000 eurosh, pasi të gjitha shpjegimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe faktet e evidentuara gjatë hetimit, të çojnë drejt përfundimit se subjekti ka paguar realisht vetëm shumën prej 70.000 eurosh. Neni D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës ka për objekt pasuritë e paligjshme, apo të ardhurat, ligjshmëria e të cilave vihet në dyshim. Nga njëra anë, konstatimi i trupit gjykues, sipas së cilit, kjo pasuri është blerë nga subjekti në vlerën prej 82.000 eurosh, nuk rezulton i mbështetur në faktet dhe provat e mbledhura gjatë hetimit. *Statementi* bankar lëshuar nga “Alpha Bank” provon bindshëm pagesën në formë transferte bankare bërë kundrejt familjes K. Arritja e një marrëveshjeje lidhur me çmimin e kontratës, me qëllim që banka të debitonte vlerën e përcaktuar sipas ofertës bankare, në vetvete nuk përbën ndonjë shkelje të dispozitave urdhëruese, ajo është një marrëdhënie private mes palëve. Zbatimi i klauzolave kontraktore për çmimin e dakorduar varet vetëm për vetëm nga pala huadhënëse dhe pala huamarrëse në raport me kushtet e marrjes së kredisë. Në mungesë të një kontestimi dhe një njoftimi të tillë nga pala kontraktore e interesuar, subjektit nuk mund t'i atribuohet ndonjë shkelje e dispozitave të kontratës.

Nga ana tjetër, nëse do të pranohet faktin se sipas kontratës është paguar shuma 82.000 euro, por subjekti nuk do të rezultonte në pamundësi financiare për ta paguar shumën në fjalë, rrjedhimisht, ai nuk do të rezultonte me situatë financiare negative, vlerësimi i kësaj pasurie do

të mbetej formalisht dhe pa u marrë parasysh rrethanat reale për realizimin e kontratës. Arsyetimi i trupit gjykues, sipas së cilit, deklarata e pasurisë e procesit të rivlerësimit nuk është dokumenti i vetëm, i mjaftueshëm për vendimmarrje, edhe deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë të mëparshme, mund të përdoren si provë nga Komisioni, në rastin konkret më duket jo bindës. Subjekti i rivlerësimit ka përmendur në DPV-në e vitit 2007, shumën prej 82.000 eurosh; në DPV-në e vitit 2009, shumën prej 70.000 eurosh; dhe në DPV-në e vitit 2014, shumën prej 70.000 eurosh; ky i fundit përkon me DPV-në para fillimit të detyrës si gjyqtare. Mendoj se fuqia provuese e aktit publik (lexo deklaratën e pasurisë), duhet të jetë lirisht e vlerësueshme nga trupi gjykues. Trupi gjykues, në arsyetimin e tij, i ka qëndruar strikt kontratës së kredisë lidhur me vlerën e përcaktuar të sendit, pa marrë në konsideratë hetimin e kryer dhe rezultatin e këtij hetimi gjatë të cilit në asnjë moment nuk u provua se vlera e paguar e sendit ka qenë 82.000 euro, por 70.000 euro.

Në këndvështrimin tim, trupi gjykues duhet të kishte pranuar rezultatin e hetimit, i cili përputhej edhe me deklarimet e subjektit dhe t'i kishte tërhequr vëmendjen subjektit për këtë veprim juridik. Gjithashtu, trupi gjykues duhet të mbante në konsideratë edhe pretendimin e subjektit në seancën dëgjimore se ajo nuk ka qenë subjekt rivlerësimi në këtë periudhë.

Vlerësimi i kësaj pasurie duhet të realizohej mbështetur në parimin e objektivitetit dhe vlerësimit të rrethanave dhe fakteve të mbledhura për këtë çështje.

2. Lidhur me mosdeklarimin nga subjekti i rivlerësimit, të vlerës së blerjes së makinës tip “Hyundai”, prodhim i vitit 2007, me targa *, në pronësi të bashkëshortit, z. A. H.**

Në ndryshim nga arsyetimi i trupit gjykues, shpreh qëndrimin se, së pari, vlera prej 5.210 eurosh e makinës për vitin 2008, në vetvete nuk është pjesë e deklarimeve në deklaratën “Vetting”. Kjo pasuri duhet të vlerësohej në raport me formularin “Vetting” ku lidhja me këtë deklaram ishte vetëm burimi i të ardhurave të përfituara nga shitja e asaj makine në vitin 2012 në vlerën 3.000 euro, e cila, nga hetimi rezultoi se përputhej me deklarimin e subjektit të rivlerësimit dhe se burimi i tyre ka qenë i ligjshëm.

Për sa i takon vlerës prej 5.100 eurosh, të cilat mbetën të pajustificuara

Mbështetur në shpjegimet e subjektit lidhur me marrëdhënien mes bashkëshortit të saj dhe motrës për financimin e këtij automjeti në vitin 2010 dhe shkëmbimit *de facto* të automjetit që në vitin 2010 dhe *de juro* në vitin 2012, duhet të vlerësoheshin nga trupa me objektivitet, pasi është fakt i provuar se kjo makinë që prej vitin 2012 është në pronësinë e motrës. Po ashtu, referuar DPV-së së vitit 2010 subjekti deklaroi se automjeti i kalon *de facto* në pronësi znj. D. H., motra e bashkëshortit, e cila disponon një aktpërdorimi.

Vlerësoj se të dhënat që vijnë në dijeni të trupës rreth ekzistencës së kësaj marrëdhënieje, kanë indikatorë të rëndësishëm që të bëjnë të besosh se një marrëdhënie e shkëmbimit të shërbimeve profesionale kundrejt pagesës, mes bashkëshortit të subjektit dhe motrës së tij, kanë ndodhur. Këtë qëndrim e mbështes në të dhënat që vijnë nga aktet e paraqitura prej subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, të cilat dëshmojnë, në vlerësimin tim, të paktën për ekzistencën e një burimi që ka prodhuar të ardhura për bashkëshortin e subjektit. Arsyetimi i trupit gjykues sipas së cilit, deklarimet e tjera për kryerjen e vlerave të financimit të makinës nuk dokumentohen nga dokumente shkresore provuese të kohës, dhe as nga deklarimet në

DPV-të e kohës, dhe vlerat e shpenzuara për blerjen e mjetit tip “Skoda” (përveç vlerës 3.000 euro), janë llogaritur si shpenzime të kryera në vitet përkatëse, nuk duket i bazuar për faktin se në rastin konkret kemi të bëjmë me një marrëdhënie të posaçme. Kjo do të thotë se marrëdhënia e posaçme sipas nenit 233, shkronja “ç”, të Kodit të Procedurës Civile, përbën një shkak ligjor që legjitimon provimin e marrëdhënies juridike edhe me deklaratimet e motrës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Neni 233 i Kodit të Procedurës Civile përbën një përjashtim të neneve 231 dhe 232 të Kodit të Procedurës Civile.

Për të gjitha këto rrethana kam mbajtur qëndrimin se, ndonëse subjekti nuk arrin të provojë bindshëm ekzistencën e marrëdhënies së dhurimit mes bashkëshortit dhe personit tjetër të lidhur, motrës së tij, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, por edhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, fakti se ky shkëmbim është kryer kur subjekti as nuk ka qenë subjekt rivlerësimi dhe as nuk afekton deklaratën “Vetting”, është një e dhënë që duhet të konsiderohet në këndvështrim të rivlerësimit të subjektit, bazuar në zbatimin e parimit të objektivitetit dhe proporcionalitetit në kuptim të nenit 52, paragrafi 1, i ligjit nr. 84/2016.

Nisur nga të dhënat e dosjes, kam ndarë qëndrim të ndryshëm me shumicën e trupit gjykues, duke mos e konsideruar këtë deklaram të vitit 2010, si një pasaktësi që mund të ngrihet në nivel të një shkakut për shkarkimin e subjektit. Ndërsa, në deklaratën e pasurisë “Vetting” subjekti ka deklaruar me vërtetësi të ardhurat e fituara realisht, të palidhura këto në mënyrë detyruese me të ardhurën e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës, (të miratuar në vitin 2016), nisur edhe nga fakti se legjislacioni i kohës nuk e kishte një definicion të tillë.

Në këtë kuptim, mendoj se fakti që trupi gjykues ia ka nënshtruar shqyrtimit dhe analizës në funksion të procesit të rivlerësimit, një pasaktësi të konstatuar në deklaratat periodike të viteve 2008 e 2010, dhe jo në deklaratën e pasurisë “Vetting”, pasuri e cila nuk impakton as pasurinë e deklaruar në deklaratën “Vetting”, del përtej qëllimit të përcaktuar në ligj. Analiza e një pasaktësie në këto DPV do t’i shërbente, në gjykimin tim, verifikimit të vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve në deklaratën e pasurisë “Vetting”, apo mund të ishte pjesë e vlerësimit tërësor të subjektit në raport me komponentin pasuri, por jo një rrethanë që mund të përdorej si shkak autonom për shkarkimin e subjektit.

Lidhur me këtë shkak kam votuar kundër, si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, në raport me rrethanat e faktit, si dhe kuadrin ligjor për procesin e rivlerësimit.

Neni D, pika 5, e Aneksit të Kushtetutës parashikon: *“Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.”* Në vlerësimin tim, kjo do të thotë se, edhe nëse pasaktësia në DPV-të do të ishte objekt verifikimi i këtij procesi në mënyrë të posaçme, përsëri, që kjo pasaktësi të konsiderohej se mund të përdorej si një shkak për shkarkimin e subjektit, duhej të ishte e shoqëruar me përpjekje për të fshehur pasurinë apo për të deklaruar me qëllim në mënyrë të pasaktë. Në thelb, do të thotë që duhej të kishim të bënim me fshehje apo deklarim të rremë në deklaratën “Vetting” për pasuri të vëna gjatë ushtrimit të funksionit. Vetëm pasaktësitë, të cilat do të mund të kualifikoheshin si fshehje apo deklarim i rremë, do të ishin

të tilla që të shkaktonin shkarkimin e subjektit në zbatim të parimit kushtetues të nenit D, pika 5, e zbërthyer në nenin 61, pika 3 dhe nenin 33, pika 5, gjerat “c” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016.

3. Lidhur me dhurimin prej 8.000 eurosh në vitin 2010, bërë bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit nga babai i tij

Në lidhje me arsyetimin e trupit gjykues, sipas të cilit shuma e pretenduar si e ardhur prej 8.000 eurosh nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike për vitin 2010, as në deklaratën “Vetting” dhe nuk bazohet në ndonjë dokumentacion ligjor në kohën e përfitimit të pretenduar, shpreh qëndrimin se bëhet fjalë për një periudhë ku subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer funksionin e gjyqtarës. Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një marrëdhënie të posaçme e cila, sipas nenit 233, shkronja “ç” të Kodit të Procedurës Civile, përbën një shkak ligjor që legjitimon provimin e marrëdhënies juridike edhe me deklaratimet e prindërve të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Neni 233 i Kodit të Procedurës Civile përbën një përjashtim të neneve 231 dhe 232 të Kodit të Procedurës Civile. Në mungesë të kësaj prove, jam dakord me përfundimin e arritur nga trupi gjykues për praninë e pamjaftueshmërisë së të ardhurave, por me tjetër arsyetim, duke zbatuar drejt parimin e proporcionalitetit.

4. Në mbështetje të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit në gjykim, parim i cili duhet të drejtojë të gjithë këtë proces, duhej vlerësuar edhe pretendimi i subjektit se e tërë problematika e konstatuar gjatë hetimit lidhur me pasurinë i përkasin periudhës kur ajo nuk ka qenë gjyqtare. Në çdo rast jam e mendimit se edhe periudha para ushtrimit të funksionit është objekt vlerësimi, por ajo duhet vlerësuar me objektivitet dhe proporcionalitet, duke e lidhur edhe me qëllimin e veprimeve dhe mosveprimeve të cilat kanë sjellë pasojën e konstatuar.

Anëtari

Valbona Sanxhaktari